



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E MBROJTJES , KUJDESIT DHE PËRFSHIRJES SOCIALE

SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës nr. Tel: Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail e-mail: info@vaudejes.gov.al

PROJEKT VENDIM

Nr. 06 datë 15.06 2021

“Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave”

Në zbatim të ligjit nr 22/2018 “Për strehimin social”, kreu V neni 33,34,35,38,39 dhe të VKM nr 362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”. Sipas relacionit të grupit të punës, Kryetari i Bashkisë Vau Dejës i propozon Këshillit Bashkiak Vau Dejës të :

VENDOSI

1. Miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave.
2. Ngarkohet për zbatimin e tij Sektori i Shërbimit Social.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

**KRYETAR
MARK BABANI**



Konceptoi
Përgjegjës/Pergj. Sek. Asistences Ligjore
Kristinë Shtatri

Miratoi:
Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit Social
Çuka Babani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS

Nr. 2818/1 Prot.

Vau-Dejes, më 11/05/2021

Lënda: Informacion për ngritjen e grupit të punës për nxjerrjen e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave.

Drejtuar: Kryetarit të Bashkisë Vau-Dejes

Z.Mark BABANI

Sot me date 11/05/2021 grupi i punës i ngritur me urdhër të brendshëm nr 146 date 06.05.2021 i përbërë nga:

- Ing. Gerralda GOGAJ
- Ark. Elsedë ZMIANI
- Ing. Emanuel MARDODA

“Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të apartamenteve” Sipas nenit 2 pika 36, të ligjit nr. 22/2018 datë 3.5.2018, “Qira mesatare” është mesatarja e ofertave të qirave, të marra gjatë një viti, në tregun e lirë.

Qira reale, është vlera aktuale e çmimit të qirasë së një banesë të caktuar në tregun e lirë.

Sa më lart, nevojitet përcaktimi i vlerave të qirasë mesatare të tregut të lirë gjatë vitit 2021 për Njësin Administrative Vau Dejë qender dhe njësitë administrative Bushat, Hajmel, Vig Mnelë, Temal, Shllak. Për efekt të përcaktimit të vlerave të qirasë mesatare, grupi i punës, në bashkëpunim me kryetarët e njësive administrative, ka kryer testime të shumta në terren, në banesat e dhëna me qira për banim. Nga studimi është konstatuar mungesa e banesave me qira ne njësitë administrative Hajmel,, Vig Mnelë Temal dhe Shllak.

Në bazë të dhënave që kemi mbledhur bashkinë e kemi ndarë ne tre kategori:

1. *Apartamente dhe shtëpia private që shtrihen përgjatë rrugëve kryesore në lagjet-qendër të qytetit.*
2. *Apartamentet dhe shtëpia private që ndodhen në lagjet periferike dhe fshatrat përreth.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS

3. *Shtëpia private që janë të pozicionuara ne fshatrat afer zonës së hidrocentralit si Spathari dhe Ashta.*

Kemi mbledhur të dhëna për tre kategoritë duke kryer sondazhe për çdo tipologji banimi : apartament (1+1) dhe (2+1) dhe shtëpi private (2+1) dhe (3+1). Nga studimi në terren vërehet mungesa e apartamenteve (3+1). Vlerat me të cilat ofrohen objektet me qira me funksion banimi në tregun e lirë, e ndarë sipas njësive administrative luhaten si vijon:

Njësia Administrative Vau-Dejës

Apartament (1+1)	6 500-7 500 lekë/muaj, mesatare 7 000 lekë
Apartament (2+1)	8 000-13 000 lekë/muaj, mesatare 11 500 lekë
Shtëpi private (2+1)	13 000-16 500 lekë/muaj, mestare 15 500 lekë
Shtëpi private (3+1)	17 000-20 000 lekë/muaj, mesatare 19 000lekë

Njësia Administrative Bushat

Apartament (1+1)	6 500-7 500 lekë/muaj, mesatare 7 000 lekë
Apartament (2+1)	8 500-12 000 lekë/muaj, mesatare 11 000 lekë
Shtëpi private (2+1)	13 000-17 000 lekë/muaj, mestare 16 000 lekë
Shtëpi private (3+1)	18 000-20 000 lekë/muaj, mesatare 19 500lekë

Në përfundim konfirmojmë se, vlerat maksimale të subvencionimit të qirasë, për rastet kur qiraja do të subvencionohet në masën 100% të vlerave të qirasë mesatare mujore, nga Bashkia Vau Dejës, për vitin në vijim, të jenë:

Apartament (1+1)	7 000 lekë/muaj
Apartament (2+1)	11 000 lekë/muaj
Shtëpi private (2+1)	16 000 lekë/muaj
Shtëpi private (3+1)	19 000 lekë/muaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS

Në rast se do të kemi kërkesa në njësit Hajmel, Temal, Shllak dhe Vig Mnelë, këto raste do të trajtohen sipas vlerave maksimale te subvencionimit të qirasë si më sipër.

Grupi i punës

Ing. Gerralda Gogaj

Ark.Elseda Zmiani

Ing.Emanuel Mardoda